



Datë: 10.10.2025
Numër Protokolli: 6779/2025

A.nr.1026/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1026/2025, të datës 30.05.2025, të parashtruar nga ankuesi H.S, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1026/2025, e datës 30.05.2025, e parashtruar nga ankuesi, H.S.
- II. **Mbetet në fuqi** Njoftimi i datës 20.05.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me përfundimin e procedurës së pranimit më numër të referencës RN00016721, për pozitën e punës *Zyrtar për Regjistrim Civil* në Drejtoratin e Pajisjes me Dokumente në Dragash, të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbimin civil, H.S (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 30.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016721, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht, për pozitën e punës Zyrtar për Regjistrim Civil në Drejtoratin e Pajisjes me Dokumente në Dragash, të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 14.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, më datë 02.06.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 3663/2025 të datës 30.05.2025 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen

e letërnjoftimit të ankuesit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 04.06.2025; Përgjigjen në ankesë së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit të datës 16.06.2025; Konkursin me numër reference RN00016721, të datës 14.02.2025; Listën e aplikantëve (të aprovuar dhe refuzuar); Vendimin për shtyerjen e afatit të verifikimit paraprak me Nr. 936 të datës 01.04.2025; Njoftimin Nr.617 të datës 11.04.2025; Vendimin Nr.552 të datës 04.04.2025; Njoftimin për përfundimin e procedurës së pranimit të datës 20.05.2025; Dëshminë nga Simbnj; Testin me shkrim të datës 30.04.2025 të ankuesit H.S; Vendimin me Nr.prot.4687/2025 të Kryetarit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se më datë 14.02.2025, Ministria e Punëve të Brendshme, ka shpallë Konkursin publik me numër reference RN00016721, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht për pozitën e punës *Zyrtar për Regjistrim Civil*, klasa e pozitës Profesional 2, një (1) vend i lirë pune, në Drejtoratin e Pajisjes me Dokumente në Dragash, me afat aplikimi nga data 15.02.2025 deri më datën 16.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsej 22 kandidatë, përfshirë edhe ankuesin, i cili ka kaluar fazën e verifikimit paraprak dhe se i njëjti i është nënshtruar fazës së vlerësimit profesional, ku në testin me shkrim ka arrit 49.2 pikë, si pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazat tjera të vlerësimit profesional, gjegjësisht intervistës me gojë.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 20.05.2025 ka publikuar njoftimin për përfundimin e procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016721, për shkak së asnjeri nga kandidatët nuk ka arritur të marrë 50 pikë në testin me shkrim.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimin ankimor së procesi i rekrutimit me nr.ref: RN00016721, është përcjell më shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit të shërbimit civil. Shton së ka dyshime në vlerësimin elektronik të testit më shkrim, pasi që, ankuesi pretendon se ka dhënë përgjigje të sakta. Ankuesi me tej deklaron se nuk i është dhënë mundësia që të shohë testin me shkrim veprim ky në kundërshtim me nenin 10 të Rregullore Nr.15/2023. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën dhe çështjen ta rikthejë në fazën e intervistës më gojë.

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”*, lidhur me këtë çështje ankimore, përveç pretendimeve ankimore ka analizuar edhe veprimet administrative të ndërmarra në procedurën e kontestuar në kuptim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe bazushmërisë së ankesës. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë, Kolegji ka analizuar shpalljen e konkursit publik me numër reference RN00016721, ku si kërkesa të përgjithshme formale në janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Arsim të lartë i paspacificuar. Përvoja e punës e kërkuar:* *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë.*

Ndërsa, në kuptim të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit i`u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë nenit 39 paragrafi 7 ku përcaktohet se: 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. 9. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatet/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës” dhe nenit 40: Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se kriteret e përgjithshme për pozitën e shpallur kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil. Komisioni i Pranimit i themeluar sipas Vendimit Nr. prot: 536, të datës 01.04.2025, të Sekretares së Përgjithshme të MPB, ka qenë në pajtim me kërkesat ligjore sipas nenit 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë. Ndërsa, lidhur me pretendimet për vlerësim në testin me shkrim dhe intervistën me gojë, Kolegji ka gjetur se procedura e testit me shkrim është realizuar në mënyrë elektronike, pyetjet e testit kanë qenë të përgatitura në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 9 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht testi ka përmbajt 25 pyetje me përgjigje të shumëfishta dhe një pyetje në formë të eseja. Rrjedhimisht, duke u bazuar në shqyrtimin e testit të aplikuar në procedurën e kontestuar Kolegji nuk vëren të meta në vlerësimin e drejtë të ankuesit lidhur me testin me shkrim, pasi që ankuesi ka dhënë 19 përgjigje të sakta duke arritur 38 pikë si vlerësim që behët nga sistemi, ndërsa, në vlerësimin e esesës si vlerësim diskrecional nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me 11.2 pikë, duke arritur gjithsej 49.2 pikë, pikë të pamjaftueshme për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit, sikurse parashihet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: 4. Testimin me shkrim e kalojnë vetëm kandidatët që marrin të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim.

Andaj, meqenëse asnjëri nga kandidatet e përfshirë në vlerësimin profesional përmes testit me shkrim nuk ka arritur numrin e mjaftueshëm të pikëve për të vazhduar me fazën tjetër të vlerësimit gjegjësisht me intervistën me gojë, siç përcaktohet me nenin 9 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, atëherë, edhe procedura përkatëse e pranimit nuk ka mundur të vazhdojë me tej, kështu që, më të drejtë njësia përgjegjëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka përfunduar procedurën përkatëse të pranimit pa kandidat të suksesshëm.

Bazuar në rrethanat dhe konstatimet e dhëna si me lartë, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1026/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, H.S;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.